



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 068/24
Data: 30.01.24

Prishtinë, 29 janar 2024
Kodi i ZRRE-së: V_1834_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenin 25, Nenit 26, paragrafit 1, nënparagrafin 1.2, Nenit 28, paragrafit 2, nënparagrafit 2.4 dhe Nenit 36 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 20 paragrafit 1.1 të Rregullës Nr. 07/2017 për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë; dhe
- Kërkesën e KOSTT SH.A për ndryshim të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë elektrike, respektivisht për lirim nga obligimi i mbulimit të humbjeve në veri, të datës 09.01.2024 (Nr. Prot. 004/24), adresa: Rr. Isa Boletini Nr.39, Prishtinë 10000, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 29 janar 2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. NDRYSHOHET, respektivisht fshihet Neni 5 i Licencës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike dhënë Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SH.A (numri i licencës ZRRE/Li_15/17), ndërsa të gjitha dispozitat tjera të licencës ZRRE/Li_15/17 mbesin në fuqi, deri me datë 04 Tetor 2036.**
- II. Obligohet ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument i cili mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së ndryshuar/modifikuar.**
- III. Ky vendim do të jetë pjesë përbërëse e Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, sipas pikës I. të dispozitivit të këtij Vendimi.**

A r s y e t i m

- Zyra e Rregullatorit për Energji (në tekstin e mëtejme: ZRRE) me datë 09 janar 2024 ka pranuar nga i licencuari KOSTT SH.A – OST, Kërkesën për ndryshim të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të Energjisë elektrike, respektivisht për lirim nga obligimi i mbulimit të humbjeve në veri.
- Sipas kërkesës së KOSTT Pala Tregtare Elektorsever SH.P.K., është Licencuar nga ZRRE për Furnizim me energji elektrike për konsumatorët e katër komuna veriore të Republikës së Kosovës (Mitrovica Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviç), sipas Licencës Nr. 1306 datës 27.06.2022.



- KOSTT SH.A ka njoftuar se pala tregtare pas nënshkrimit të marrëveshjes komerciale ndërmjet KEDS dhe Elektrosever, KOSTT ka filluar me përgatitjet dhe i ka dërguar palës tregtarë respektive, në rolin e Furnizuesit të ri, të gjitha udhëzimet për të mundësuar operimin në Zonën Rregulluese të KOSTT, në përputhje me Rregullat e Tregut.
- Ka njoftuar se me datën 01.01.2024, Furnizuesi i ri (Elektrosever) ka filluar të dorëzoj në KOSTT (KOSTT Sistemi për Menaxhimin e Tregut MMS), Nominimet Fizike dhe Kontraktuale për konsumin e energjisë për të gjithë konsumatorët.
- Ndërsa në anën tjetër, përmes Nenit 5 të licencës për Operatorin e Sistemit të transmetimit të Energjisë Elektrike, ZRRE/Li_15/17 i dt. 13.04.2017 është i obliguar që të mbuloj humbjet që dalin nga energjia e shfrytëzuar por jo e paguar e konsumatorëve në pjesën veriore të Kosovës.
- Andaj, referuar rrethanave të krijuara KOSTT kërkon nga ZRRE që në pajtim me Nenin 36 par. 1 nënpar. 1.1 dhe Neni 37 par. 1 nënpar 2 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, largimin e detyrimit për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në veri të Kosovës të përcaktuar me Nenin 5 të Licencës.
- ZRRE pas pranimit të Udhërrëfyesit për Zbatimin e Marrëveshjeve të Energjisë e datës 21.06.2022, përmes Vendimit V_1515_2022, i ka lëshuar Licencë për Furnizim me energji Elektrike ndërmarrje Drustvo Elektrosever D.O.O., me nr. Licence ZRRE/Li_70/20, për periudhën 5 vjeçare, që mbulon periudhën nga data 24 qershor 2022 deri 23 qershor 2027, për konsumatorët në katër komunat veriore të Kosovës (Mitrovica Veriore, Zvecan, Zubin Potok dhe Leposavic), me disa kushte që duhet të plotësohen para fillimit të operimit.
- Shoqëria Elektrosever D.O.O. ka qenë e obliguar që para fillimit të furnizimit me energji në katër komunat veriore, të lidh disa marrëveshje me KOSTT, kështu që: a) Elektrosever ka nënshkruar Marrëveshjen për Aderim në Rregullat e Tregut; b) Marrëveshjen për Palën Përgjegjëse për Balanc dhe c) Marrëveshjen për Blerje të Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE), përmes të cilave obligohet të respektoj Rregullat e Tregut dhe merr përgjegjësinë për jobalancet që i shkakton. KEDS dhe Elektrosever kanë finalizuar Marrëveshjen e Kyçjes dhe atë Komerciale me datë 09.12.2023.
- KOSTT pas finalizimit të marrëveshjeve përkatëse, ka filluar përgatitjet dhe i ka dërguar Palës Tregtare, respektive, në rolin e Furnizuesit të ri, të gjitha udhëzimet për të mundësuar operimin në Zonën Rregulluese të KOSTT, në përputhje me Rregullat e Tregut. Kështu nga 01.01.2024, Furnizuesi i ri ka filluar të dorëzoj në KOSTT (Sistemi për Menaxhimin e Tregut-MMS) Nominimet Fizike dhe Kontraktuale për konsumin për të gjithë konsumatorët.
- ZRRE pas vlerësimit të Kërkesës së KOSTT – OST dhe marrë parasysh marrëveshjet e nënshkruara për furnizim në katër komunat veriore të Kosovës, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.




- o Licenca e ndryshuar/modifikuar sipas pikës I të dispozitivit të këtij vendimi, do të vazhdojë të jetë e vlefshme për periudhën sipas pikës I. të dispozitivit të këtij Vendimi dhe licencës me numër ZRRE/Li_15/17 e datës 13 prill 2017, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës në pajtim me Nenin 32 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe legjislacionin tjetër në fuqi.


IV. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Bucaj, Anëtar


Arta Isufi, Anëtare


Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës, dhe
- Arkivit të ZRRE-së



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



LICENCË PËR OPERATORIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

DHËNË :

OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMISIONIT DHE TREGUT (KOSTT) SH.A

Numri i Licencës: ZRRE/Li_15/17

Prishtinë, 13 prill 2017

PËRMBAJTJA

Neni 1	Qëllimi	3
Neni 2	Përkufizimet	3
Neni 3	Të drejtat dhe detyrimet.....	4
Neni 4	Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Operatorit të Transmetimit.....	4
Neni 5	Kompensimi për humbjet në Veri të Kosovës.....	5
Neni 6	Ndalimi i Subvencioneve, Ndër-Subvencioneve dhe Ndalimi i Diskriminimit	6
Neni 7	Kodi i Rrjetit të Transmetimit.....	6
Neni 8	Kodi i Matjes.....	6
Neni 9	Pajtueshmëria me Kodin e Rrjetit të Transmetimit, Kodin e Matjes, Kodin e Shpërndarjes dhe Rregullat e Tregut	6
Neni 10	Funksionimi i Sistemit të Transmetimit	7
Neni 11	Tarifat dhe Taksat për shfrytëzim dhe Kyçe të Rrjetit të Transmetimit	7
Neni 12	Planet Zhvillimore	8
Neni 13	Zotimi për zhvillimin e infrastrukturës.....	8
Neni 14	Bilancet e Energjisë Elektrike	9
Neni 15	Disponueshmëria dhe mirëmbajtja e të dhënave	9
Neni 16	Interkonektorët.....	9
Neni 17	Mekanizmi Kompensues ndër-OST (ITC).....	10
Neni 18	Operimi i Sistemit.....	11
Neni 19	Blerja Ekonomike e Aseteve, Shërbimeve dhe Shërbimeve Ndihmëse.....	11
Neni 20	Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve Relevante	12
Neni 21	Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmetimit.....	12
Neni 22	Standardet e Sigurisë së Operimit	13
Neni 23	Standardet e Përgjithshme dhe Minimale të Përbushjes së Aktiviteteve të Operimit të Transmetimit	14
Neni 24	Qasja në Tokë dhe /ose në Ndërtesa	14
Neni 25	Kufizimi në Përdorimin e Informatës së Caktuar	15
Neni 26	Dhënia e Informatave Operatorëve të tjerë të Sistemit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes	15
Neni 27	Pavarësia Ligjore dhe Menaxheriale	16
Neni 28	Rregullat e Tregut dhe Integrimi i Tregut	16
Neni 29	Shëndeti dhe Siguria	17
Neni 30	Puna	17
Neni 31	Obligimi i Sigurimit	17
Neni 32	Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit dhe Certifikimi i të Licencuarit	17
Neni 33	Obligimet e Shërbimit Publik	18
Neni 34	Sigurimi i Informacioneve ndaj Rregullatorit	18
Neni 35	Taksat	19
Neni 36	Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës	19
Neni 37	Masat Administrative dhe Gjobat.....	19
Neni 38	Zgjidhja e Kontesteve	19
Neni 39	Hyrja në fuqi.....	20

Neni 1 Qëllimi

1. **Zyra e Rregullatorit për Energji** - ZRRE (në tekstin e mëtejshëm "Rregullatori"), në pajtim me autoritetin e dhënë në Nenin 36 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084), Ligjin për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081), Ligjin për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085) dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017) si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë së Kosovës për caktimin Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) si operator i vetëm i rrjetit të Transmetimit të energjisë elektrike, nëpërmjet kësaj në seancën e datës 13 prill 2017, i ndryshon (modifikon) Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) - SH.A. Licencën për Operator të Sistemit të Transmisionit të Energjisë Elektrike (me numër licence ZRRE/Li_15/12) në **Licencë për operatorin e sistemit të transmetimit, dhënë Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) Sh.A., tani me numër regjistrimi ZRRE/Li_15/17, Adresa: Rr."Iliaz Kodra" pn. 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës**, (në tekstin e mëtejshëm "i Licencuari").
2. Ndryshimi/modifikimi i kësaj licence vjen si rezultat i ndryshimeve të Legjislacionit primar të sektorin të Energjisë: Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085, i cili ka hyrë në fuqi në gusht 2016); Ligjit për Gazin Natyror (Ligji Nr. 05/L-082, i cili ka hyrë në fuqi në korrik 2016); si dhe Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla ZRRE/Nr.07/2017, e cila ka hyrë në fuqi me 31 mars 2017).

Neni 2 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë licencë do të kenë kuptimin si në vijim:
 - a) **Plan Zhvillimor** - çdo plan zhvillimor i përgatitur nga i Licencuari, sipas Nenit 10 të Ligjit për Energjinë dhe Nenit 16 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
 - b) **Vit financiar** - periudha prej 1 Janar deri më 31 Dhjetor të të njëjtit vit kalendarik.
 - c) **Shoqëri Aksionare** - çdo kompani e definuar si e tillë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
 - d) **Rregulla të Tregut** - norma të cilat rregullojnë tregtimin e energjisë elektrike ndërmjet pjesëmarrësve në treg dhe marrëdhëniet ndërmjet palëve në tregun e energjisë elektrike, Operatorit të Tregut dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit, me qëllim të mirëmbajtjes së bilancit fizik të tregut.
 - e) **Kode** – rregulla që synojnë të vendosin standardet minimale të dizajnit teknik, kërkesat dhe standardet operacionale, dhe kushtet komerciale për aktivitete relevante në sektorin e energjisë, të cilat me ligj kërkohet të dorëzohen në

Rregullator për aprovim.

- f) **Person i ndërlidhur** - çdo ndërmarrje në pronësi apo e kontrolluar nga një ndërmarrje tjetër, siç është përcaktuar në Ligjin për Shoqëritë Tregtare, në fuqi.
 - g) **Legjislacion** – Ligji për Energjinë (Ligji nr. 05/L-081), Ligji për Rregullatorin e Energjisë (Ligji nr. 05/L-084), Ligji për Energjinë Elektrike (Ligji nr. 05/L-085) si dhe çdo legjislacion tjetër primar apo sekondar që rregullon sektorin e energjisë.
2. Shprehjet tjera të përdorura në këtë licencë do të kenë të njëjtin kuptimin si shprehjet e përdorura në Legjislacionin në fuqi.

Neni 3 **Të drejtat dhe detyrimet**

1. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me Nenet e përcaktuara në këtë licencë, Ligjin për Energjinë Elektrike si dhe ligjet, rregulloret, rregullat dhe kodet në fuqi.
2. I Licencuari do të veproj si vijon:
 - 2.1. të kryej në mënyrë efikase obligimet e përcaktuara me këtë licencë;
 - 2.2. të operoj, mirëmbaj dhe zhvilloj sistemin e transmetimit dhe linjat ndër-kufitare në mënyrë efikase, ekonomike dhe të koordinuar;
 - 2.3. bën balancimin e sistemit dhe zbatimin e marrëveshjeve të aranzhuara duke nxitur efikasitetin e tij, në harmoni me Rregullat e Tregut.
 - 2.4. kryen funksione të tjera të caktuara nga Ligji për Energjinë Elektrike, Rregullat e Tregut dhe kjo licencë.
3. Territori që mbulohet nga kjo licencë është i tërë territori i Republikës së Kosovës.
4. Të Licencuarit mund të mos i jepet licencë për ndonjë aktivitet tjetër të energjisë elektrike përveç deri në masën që i Licencuari vepron në pajtueshmëri me kërkesat e pavarësisë dhe shthurjes të Nenit 11.2 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe legjislacionit në fuqi.

Neni 4 **Llogaritë e Ndara për Aktivitetin e Operatorit të Transmetimit**

1. I Licencuari do të përgatisë Pasqyrat Financiare Vjetore për aktivitetet që mbulohen nga kjo licencë, duke përjashtuar aktivitetet e Operatorit të Tregut, në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitetin, të nxjerrë nga Rregullatori, dhe do t'i dorëzoj Rregullatorit një kopje të Pasqyrave Financiare të audituara, brenda tre (3) muajve, pas përfundimit të vitit financiar. Në rast se i licencuari për arsye objektive nuk mund të përgatis këto pasqyra brenda tre (3) muajve, atëherë jo më vonë se 15 mars, i licencuari

duhet të kërkojë nga rregullatori shtyrje afati, por jo më vonë se 30 prill të vitit aktual, për dorëzim të këtyre pasqyrave.

2. I Licencuari do të dorëzoj në Rregullator Pasqyrat Financiare Vjetore të audituara nga auditor i pavarur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar brenda afateve të përcaktuara me ligjet në fuqi për raportimin financiar. Auditori duhet të verifikoj se kërkesat lidhur me ndalim e ndër-subvencioneve dhe diskriminimit, në Nenin 6 të kësaj licence, janë përmbushur.
3. I Licencuari në kontabilitetin e tij të brendshëm do të mbajë kontabilitetin për aktivitetin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit në tërësi, si dhe për aktivitetet tjera. Kontabiliteti rregullativ do të jetë në përputhje me Udhëzimet Rregullative për Kontabilitet, i cili ndër të tjera mund të specifikoj:
 - 3.1. formën e deklaratave/regjistrave të kontabilitetit rregullativ , duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në llogaritë e fitimeve dhe humbjeve, bilanci, fitimet e njohura dhe deklaratat e humbjeve, rrjedhjen e parave të gatshme dhe deklaratat për shumat e të ardhurave vjetore, kostove, aseteve, borxheve, rezervave ose furnizimeve, të cilat janë tarifuar nga ndonjë aktiviteti tjetër, ose janë përcaktuar nga alokimi ose shpërndarja midis aktiviteteve të konsoliduara të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe ndonjë aktiviteti tjetër;
 - 3.2. natyrën dhe përmbajtjen e deklaratave/regjistrave të kontabilitetit rregullativ, duke përfshirë informacione mbi lloje të specifikuara të të ardhurave vjetore, shpenzimeve, aseteve ose borxheve, dhe informacione mbi të ardhurat vjetore, asetet, shpenzimet dhe borxhet nga aktivitetet e specifikuara; dhe
 - 3.3. parimet dhe politikat e kontabilitetit rregullativ (duke përfshirë bazat për alokimin e shpenzimeve).
4. Në lidhje me deklaratat e kontabilitetit rregullativ për sa i përket vitit financiar, i Licencuari nuk do të ndryshoj bazën e ngarkesës, shpërndarjes ose alokimit nga ato të përdorura në vitin financiar paraprak, përveç nëse Rregullatori nxjerr më parë udhëzimin relevant ose jep aprovimin me shkrim për ndryshimin e këtyre bazave.
5. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me çdo udhëzim të nxjerrë nga Rregullatori dhe legjislacioni në fuqi.

Neni 5

~~Kompensimi për humbjet në Veri të Kosovës~~

- ~~1. Kur kërkohet me ndonjë Vendim apo Udhëzim lëshuar të Licencuarit nga Rregullatori, i Licencuari duhet të siguroj energji elektrike për të kompensuar humbjet që dalin nga energjia e shfrytëzuar, por jo e paguar, nga konsumatorët në pjesën veriore të Kosovës.~~

~~2. Në llogaritë e tij rregullative, i Licencuari duhet të sigurohet se regjistron ndarazi ndonjë kosto të shkaktuar nga ai për blerjen e energjisë, sipas paragrafit 1 të këtij neni.¹~~

Neni 6

Ndalimi i Subvencioneve, Ndër-Subvencioneve dhe Ndalimi i Diskriminimit

1. I Licencuari do të parandalojë apo evitojë që aktiviteti i licencuar të japë apo të marrë ndonjë subvencion apo ndër-subvencion (direkt apo të tërthortë) prej ndonjë aktiviteti tjetër të të Licencuarit dhe/ose ndonjë Vartësi (ortaku) apo anëtar, dhe/ose ndonjë personi tjetër.
2. Gjatë vendosjes së çmimeve që do t'u ngarkohen shfrytëzuesve të sistemit të transmetimit, i Licencuari nuk duhet të ketë preferencë për ndonjë përdorues apo kategori të përdoruesve, nuk duhet që në mënyrë të paarsyeshme të ushtroj diskriminim ndaj ndonjë përdoruesi apo kategorie të përdoruesve dhe nuk duhet të vendos kushte dhe afate të padrejta dhe të vështira për kyçje në sistem apo përdorim të tij.

Neni 7

Kodi i Rrjetit të Transmetimit

1. I Licencuari do të ndërmarr të gjithë hapat brenda kompetencave të tij për t'u siguruar që Kodi i Rrjetit në fuqi, në kuadër të kësaj licence mbetet një kod që përputhet me kërkesat e Nenit 17 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe legjislacionit tjetër në fuqi.
2. Deri në masën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi dhe kërkesat e Rregullatorit, i Licencuari duhet të koordinoj punën e tij në zhvillimin e Kodeve të Rrjetit dhe Rregullave për menaxhimin e kongjestioneve me OST-të e tjera të shteteve fqinjë dhe pjesëmarrësit tjerë në treg, sipas nevojës.

Neni 8

Kodi i Matjes

I Licencuari duhet të ndërmarr të gjithë hapat brenda autoritetit të tij që të siguroj se Kodi i Matjes në fuqi, në kuadër të kësaj licence, është në pajtim me kërkesat e Nenit 18 të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe legjislacionit tjetër në fuqi, dhe se është aprovuar nga ZRRE.

Neni 9

Pajtueshmëria me Kodin e Rrjetit të Transmetimit, Kodin e Matjes, Kodin e Shpërndarjes dhe Rregullat e Tregut

I Licencuari do të veproj në përputhje me dispozitat e Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes dhe Kodit të Shpërndarjes dhe Rregullave të Tregut.

¹ I fshirë sipas Vendimit të Bordit të Zyrës së Rregullatorit për Energji Nr. V_1834_2024, të datës 29.01.2024.

Neni 10

Funksionimi i Sistemit të Transmetimit

1. I licencuari duhet të planifikoj, operoj, mirëmbaj dhe zhvilloj sistemin e transmetimit në përputhje me Kodet teknike, rregullat dhe legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari është përgjegjës për funksionimin efikas, ekonomik dhe të koordinuar të sistemit të Transmetimit, duke përfshirë rrjedhat ndërkufitare të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin në fuqi
3. I Licencuari duhet të ofroj kushte për kyçe në rrjetin transmetues dhe përdorim të sistemit të transmetimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji. Për çdo kontest që mund të paraqitet nga kyçja në rrjetin transmetues apo përdorimi i Sistemit të Transmetimit, do të zbatohen dispozitat e Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë, të nxjerrë nga Rregullatori.
4. I Licencuari do të siguroj qasje jo diskriminuese për shfrytëzuesit e sistemit apo kategoritë e shfrytëzuesve të sistemit të transmetimit, dhe t'u siguroj informatat që ju nevojiten për qasje efikase në sistem të transmetimit, në përputhje me Ligjin për Energjinë.
5. Në faqen e tij elektronike, i Licencuari duhet të publikoj Metodologjinë e Ngarkesave për Shfrytëzimin e Rrjetit të Sistemit të Transmisionit (TNUOS) dhe Metodologjinë e Taksave për Kyçe në Rrjetin e Transmetimit, të aprovuar nga Rregullatori. Po ashtu duhet të publikoj kodet teknike dhe komerciale, procedurat dhe informacionet që janë të rëndësishme për shfrytëzuesit e sistemit të transmetimit, duke përfshirë: kapacitetet ndër-kufitare, fytet e ngushta (kongestionet) në sistemin e interkoneksionit dhe intra-transmetimit (brenda rrjetit të transmetimit), dhe informata të tjera të kërkuara për organizimin e tregut të energjisë elektrike.

Neni 11

Tarifat dhe Taksat për shfrytëzim dhe Kyçe të Rrjetit të Transmetimit

1. I Licencuari do t'u vendos Palëve detyrime të aplikueshme për operimin e sistemit, shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit dhe kyçjen në rrjet (Detyrimet e Operatorit të Sistemit), ashtu siç përcaktohet në Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, Rregullat e Tregut dhe Metodologjinë për Kyçe.
2. Tarifat për shfrytëzimin e rrjetit të transmetimit do të përcaktohen në bazë të Metodologjisë së Ngarkesave për Shfrytëzimin e Rrjetit të Sistemit të Transmisionit (TNUOS), ndërsa taksat për kyçe në rrjetin e transmetimit do të përcaktohen në bazë të Metodologjisë së Taksave për Kyçe në Rrjetin e Transmetimit.
3. Në përcaktimin e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të transmetimit dhe taksave për kyçe, i Licencuari do të siguroj sinjale të duhura për çmime jo diskriminuese ashtu që

inkurajon palët e reja për kyçje në rrjetin e transmetimit dhe qasjen në tregun e energjisë elektrike.

4. I Licencuari do të publikojë në faqen zyrtare elektronike të tij Rregullën për Vendosjen e Çmimeve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe të Tregut (Rregulla për Çmimet e OST/OT-së), Metodologjinë e Ngarkesave të Operatorit të Sistemit (TNUOS), Metodologjinë për Kyçje në Rrjetin e Transmetimit si dhe dokumente tjera për shfrytëzim apo kyçje në rrjetin e transmetimit.
5. I licencuari do të veprojë në pajtim me nenin 16 të ligjit për energjinë elektrike dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Neni 12

Planet Zhvillimore

1. Në përputhje me Nenin 10 të Ligjit për Energjinë dhe Nenin 16, nënparagrafët 1.11, 1.12 dhe 1.13, të Ligjit për Energjinë Elektrike, i Licencuari do të hartoj dhe publikoj Planin Zhvillimor Investiv afatmesëm (5 vjeçar), që rrjedhin nga Plani Zhvillimor afatgjatë i Sistemit të Transmetimit dhjetë (10) vjeçar. Plane të tilla zhvillimore do të hartohen në përputhje me legjislacionin në fuqi duke konsultuar shfrytëzuesit aktual dhe potencial të sistemit.
2. Para se të publikohen, draft-planet zhvillimore të OST-së duhet të jenë në dispozicion (të shkëmbehen) me draft-planet zhvillimore të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) dhe i Licencuari duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e mundshme për harmonizimin e planeve të tij me ato të OSSH-së, pa ndonjë vonesë të paarsyeshme. I Licencuari duhet t'i dorëzoj planet zhvillimore në Rregullator për aprovim.
3. I Licencuari do të rishikojë planin zhvillimor afatgjatë çdo vit, në koordinim me OSSH-në, në mënyrë që të sigurohet se informacioni i paraqitur në planin zhvillimor, të vazhdoj të jetë i saktë në të gjithë aspektet thelbësore. Çdo propozim për ndryshim të Planit Zhvillimor do të dorëzohet në Rregullator për aprovim.
4. I Licencuari duhet që gjatë planifikimit të operimit të sistemit transmetimit të energjisë elektrike, në mënyrë aktive dhe transparente të bashkëpunoj me Operatorin e Tregut, Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes, shfrytëzuesit e sistemit të transmetimit dhe operatorët e sistemeve transmetuese fqinje, sipas Nenit 16, nënparagrafi 1.4 të Ligjit për energjinë elektrike.

Neni 13

Zotimi për zhvillimin e infrastrukturës

1. I Licencuari do të veproj në përputhje me zotimin e zhvillimit të infrastrukturës që rrjedh prej Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë të miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si dhe çdo zotim për infrastrukturën që rrjedh nga Ligji për Energji. Kur zotimet për zhvillim të infrastrukturës i shkaktojnë të Licencuarit shpenzime shtesë, ato shpenzime do t'i kthehen të licencuarit në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. I Licencuari do të raportoj çdo vit në Rregullator mbi aktivitetet që kryhen, në lidhje me zotimin e zhvillimit të infrastrukturës.

Neni 14 **Bilancet e Energjisë Elektrike**

I Licencuari, pas marrjes së mendimit nga Ministria përkatëse për Energji, do të dërgojë për miratim te Rregullatori Bilancet e Energjisë elektrike, me parashikimet e nevojshme afatgjata dhe vjetore, në pajtim me Nenin 8 të Ligjit për Energji dhe rregullat tjera në fuqi.

Neni 15 **Disponueshmëria dhe mirëmbajtja e të dhënave**

1. I Licencuari do të siguroj që shfrytëzuesit aktual dhe ata potencial të Sistemit të Transmetimit do të kenë qasje jo-diskriminuese në informatat që atyre ju nevojiten për të pasur qasje efikase në sistem, në pajtim me Ligjin për Energji Elektrike.
2. I Licencuari do të marr të gjitha masat e nevojshme për të siguruar dhe zbatuar të gjitha detyrimet që dalin nga legjislacioni në fuqi, licenca dhe marrëveshjet e lidhura.
3. I Licencuari është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe publikimin e të dhënave për kapacitetet ndërkufitare, operimin e interkonektorëve, menaxhimin e kongjestioneve, dispeçimin e kapaciteteve gjeneruese, shfrytëzimin e shërbimeve ndihmëse si dhe funksionimin e tregut balancues, si dhe të drejtat dhe obligimet lidhur me përdorimin e gjithë teknologjisë informative për operim të sigurt dhe të besueshëm të sistemit (harduerit dhe softuerit të nevojshëm për llogaritjen e rrjedhave të energjisë dhe informatat tjera).
4. Rregullatori mund të kërkoj nga i Licencuari që të mbledh dhe mirëmbaj informata, regjistra dhe dokumente në përputhje me Nenin 18 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.

Neni 16 **Interkonektorët**

1. Në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike dhe Rregullat e Tregut, i Licencuari bënë alokimin e kapaciteteve të linjave interkonektive me sistemet tjera në harmoni me procedurat e qarta dhe transparente për alokimin dhe shfrytëzimin e linjave interkonektive (ndërlidhëse), duke përfshirë menaxhimin e transmetimit të energjisë elektrike nëpër Sistemin e Transmetimit. Procedurat përkatëse dhe ndryshimet e tyre do të dorëzohen në Rregullator për aprovim.
2. Licencuari jo më vonë se tre (3) muaj pas plotësimit të kushteve për pjesëmarrje në alokimin e kapaciteteve interkonektive transmetuese rajonale, do të zbatoj Rregullat për alokim të koordinuar të kapaciteteve interkonektive transmetuese dhe për çdo

ndryshim të rregullave për alokim të kapaciteteve regjionale, i Licencuari do të njoftojë Rregullatorin..

3. Në bazë të Programit të Zbatimit të Strategjisë së Energjisë dhe sipas nevojave të regjionit, i Licencuari do të vlerësoj dhe zhvilloj mundësitë për të ndërlidhur Sistemin e Transmetimit të Kosovës me sistemet tjera, do të përgatis çdo dy (2) vjet listën e kapaciteteve të reja të transmetimit dhe linjave interkonektive si dhe do të veproj në pajtim me çdo udhëzim të Rregullatorit dhe dispozitat relevante të legjislacionit në fuqi.
4. I Licencuari duhet të përgatis, për çdo interkonektor dhe pas komisionimit të çdo linje interkonektive (ndërlidhëse) të re, një deklaratë për Rregullatorin, sa më shpejt që të jetë e mundur, dhe në çdo rast, jo më vonë se në datën e përcaktuar nga Rregullatori, ku tregohen:
 - 4.1. sasia totale e kapacitetit të çdo interkonektori dhe të gjithë interkonektorëve e parashikuar nga i Licencuari në baza vjetore, mujore dhe ditore, që do të jetë në dispozicion për transmetim në baza ditore të energjisë elektrike nga territori i veprimit të të Licencuarit tek Operatorët tjerë të transmetimit jashtë territorit të tij dhe anasjelltas;
 - 4.2. margjina e kapacitetit rezervë të çdo interkonektori, që është propozuar nga i Licencuari dhe/ose nga ndonjë operator tjetër i sistemit të transmetimit për sigurinë e sistemit; etj.
4. I Licencuari do të azhurnoj në mënyrë të rregullt kapacitetet vjetore, mujore dhe ditore në dispozicion, të paraqitura sipas paragrafit 3 të këtij Neni, dhe në rast të modifikimit, menjëherë do ta njoftoj Rregullatorin.
5. Deklaratat e modifikuara do të publikohen në faqen elektronike zyrtare të të Licencuarit.

Në këtë Nen:

“Rregullat për alokim të koordinuar (regjionale)” - rregulla obliguese për alokimin e kapaciteteve transmetuese të nxjerra sipas marrëveshjeve ndërkombëtare

Neni 17

Mekanizmi Kompensues ndër-OST (ITC)

1. I Licencuari duhet të ndërmarr të gjitha masat e nevojshme për të mbledhur të hyra nga Mekanizmi ITC për transitin e energjisë elektrike nëpër rrjetin transmetues të Kosovës, dhe të bëjë pagesa në kuadër të mekanizmit kompensues ndër-OST, sipas Nenit 16, paragrafi 8 të Ligjit për Energjinë Elektrike.
2. I Licencuari duhet, së paku një herë në tre (3) muaj, të njoftoj ZRRE-në nëse ka qenë në gjendje të kryejnë detyrat e tij, sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Neni 18

Operimi i Sistemit

1. I Licencuari do të lëshoj urdhëresa direkte për dispeçimin e të gjitha njësive gjeneruese në përputhje me mekanizmin balancues për ndryshimin e pikës së punës brenda kufijve dinamik, ndryshimin e ngarkesës sipas mekanizmit balancues dhe mjeteve tjera të nevojshme për balancimin e sistemit në përputhje me Kodin e Rrjetit dhe Rregullat e Tregut.
2. I Licencuari bën miratimin e programit një ditë para, sipas kërkesave dhe standardeve të pëcaktuara në Kodin e Rrjetit, Rregullat e tregut dhe legjislacionin tjetër në fuqi.
3. Gjatë nominimit dhe dispeçimit të energjisë së prodhuar, i Licencuari do t'i jap prioritet energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe ko-gjenerimit siç kërkohet me Kodin e Rrjetit dhe në përputhje me Legjislacionin në fuqi.
4. I licencuari mirëmban sistemet matëse, grumbullon dhe distribuon matjet komerciale për qëllim të barazimit përfundimtar, në përputhje me Kodin e Matjes dhe Rregullat e Tregut.
5. I Licencuari do t'i raportoj Rregullatorit, në lidhje me funksionimin e sistemit, ose ndonjë aspekt tjetër të funksionimit, sipas kërkesave të Rregullatorit.

Neni 19

Blerja Ekonomike e Aseteve, Shërbimeve dhe Shërbimeve Ndhmëse

1. I Licencuari do të kontraktoj dhe siguroj asetet dhe shërbimet që janë të nevojshme për t'i mundësuar atij që të kryej detyrimin e tij sipas Kodit të Rrjetit. Kontraktimet e tilla do të bëhen në përputhje me Ligjin për Prokurimin publik dhe legjislacionin tjetër relevant në fuqi në Kosovë.
2. I licencuari do të jetë përgjegjës për aranzhimin e provizioneve të sasive dhe llojeve të shërbimeve ndhmëse, do të prokuroj në përputhje me Ligjin për Energji Elektrike dhe procedurave për prokurim, siç mund të jetë e nevojshme në mënyrë që të Licencuarit t'i mundësohet kryerja e obligimeve të dhëna në Kodin e Rrjetit. Duke bërë këtë, i Licencuari duhet të jetë në pajtim me Kodin e Rrjetit dhe Rregullat e Tregut dhe duhet të reflektojë parimet e efijencës, mos-diskriminimit dhe transparencës.
3. Gjatë kontraktimit për sigurimin e asetëve dhe shërbimeve në përputhje me paragrafin 1 dhe 2 të këtij Neni, i Licencuari, do të blej ose do të siguroj ato asete, shërbime dhe shërbime ndhmëse nga burimet më ekonomike që ka në dispozicion.
4. Duke marr parasysh burimet më ekonomike që ka në dispozicion, i Licencuari duhet të ketë parasysh sasinë, natyrën, shumëllojshmërinë, numrin dhe sigurinë e asetëve të tilla, shërbimeve dhe shërbimeve ndhmëse që janë në dispozicion për blerje ose për

përvetësim tjetër, dhe sipas nevojave të tij t'i mundësoj që ai t'i kryej obligimet sipas Legjislacionit në fuqi, Kodit të Rrjetit dhe kësaj licence.

Neni 20

Regjistrimi dhe Tjetërsimi i Aseteve Relevante

1. I Licencuari do të përgatis dhe do të mbaj një regjistër të të gjithë asetëve relevante dhe do t'ia dorëzoj Rregullatorit me çdo ndryshim në regjistër jo më vonë se më 31 mars të çdo viti.
2. I Licencuari nuk do të shes apo heq dorë nga kontrolli funksional mbi ndonjë aset relevant, nëse kjo do të ndikonte në aftësinë e tij për të kryer detyrimet e tij. Në rast kur i Licencuari dëshiron të tjetërsoi asetet, apo pasuritë tjera që përdoren në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, ku vlera e tyre tejkalon shumë njëqind mijë euro (100,000.00 €), i Licencuari do të obligohet që ta njoftoj Rregullatorin. I Licencuari mund ta bëjë tjetërsimin e ndonjë aseti të tillë vetëm pas miratimit me shkrim nga Rregullatori.

Në këtë Nen:

"Tjetërsim"- çdo shitje, transferim, dhurim, dhënie me qira, hua, hipotekë, ngarkimin, kufizim mbi shfrytëzimin (qoftë ky fizik ose ligjor) ose ndonjë ngarkesë tjetër, si dhe lejimin e ndonjë ngarkese ndaj një aktiviteti tjetër të të Licencuarit dhe/ose pale të tretë.

"Aset relevant" nënkupton:

- a) Çdo pajisje e Sistemit të Transmetimit që shfrytëzohet nga i Licencuari për të kryer funksionet e veta siç përcaktohet në paragrafin 2 të këtij Neni;
- b) Çdo interes ligjor ose përfitues mbi token dhe/ose ndërtesat në të cilat janë vendosur të sipërpërmendurit, dhe/ose që shfrytëzohet nga i Licencuari për të kryer funksionet që përcaktohen në këtë licencë; dhe
- c) Çdo e drejtë pronësore përkatëse intelektuale.

Neni 21

Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmetimit

1. I Licencuari, është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe kur është e domosdoshme rifreskimin/përditësimin e dokumentit Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmetimit. Çdo rifreskim/përditësimin i dokumentit duhet të dërgohet në Rregullatorit për aprovim.
2. I Licencuari do t'i zbatoj Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmetimit dhe do të jetë përgjegjës për funksionimin, sigurimin e mirëmbajtjes së Sistemit të Transmetimit dhe nëse është e nevojshme, edhe zhvillimin e tij në përputhje me Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmetimit si dhe me standarde të tjera të planifikimit dhe operimit të cilat i Licencuari mund t'i zbatoj, pas aprovimit nga Rregullatori.

3. I Licencuari do të shqyrtojë kohë pas kohe zbatimin e Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmetimit dhe do të dorëzoj në Rregullator:
 - 3.1. një raport të rezultateve të këtij shqyrtimi; dhe
 - 3.2. propozimin për amendamentim eventual të Standardeve të Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmetimit.
4. Rregullatori mund të nxjerrë udhëzime që i kërkon të Licencuarit të rishikojë Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmetimit në atë mënyrë që është specifikuar në udhëzime.
5. I Licencuari do të publikojë në faqen elektronike zyrtare të tij, Standardet e Sigurisë dhe Planifikimit të Sistemit të Transmetimit.

Neni 22

Standardet e Sigurisë së Operimit

1. I Licencuari do të implementoj Standardet e Sigurisë së Operimit, të aprovuara nga Rregullatori.
2. I Licencuari do ti zbatoj Standardet e Sigurisë së Operimit dhe do të jetë përgjegjës për funksionimin e Sistemit të Transmetimit në përputhje me këto Standarde.
3. Gjatë planifikimit dhe mirëmbajtjes i licencuari do të mbajë një nivel të përshtatshëm të kapacitetit të rezervave teknike të transmetimit, për sigurinë operuese të rrjetit dhe të bashkëpunojë në koordinimin e sigurisë operuese të rrjetit me operatorët e sistemeve të Palëve Kontraktuese të Komunitetit të energjisë, me të cilat është i interkonektuar.
4. I Licencuari do të rishqyrtoj herë pas here zbatimin e Standardeve të Sigurisë së Operimit dhe nëse ka ndryshime, do të dorëzoj në Rregullator:
 - 4.1. një raport të rezultateve të rishqyrtimit të tillë; dhe
 - 4.2. ndryshimet që propozohen t'u bëhen Standardeve të Sigurisë së Operimit.
5. Rregullatori mund të nxjerr udhëzime me të cilat kërkon nga i Licencuari që t'i rishikoj Standardet e Sigurisë së Operimit në mënyrën që specifikohet në ato udhëzime, dhe i Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me ato udhëzime.
6. I Licencuari do të publikoj Standardet e Sigurisë së Operimit në faqen e tij zyrtare elektronike.

Neni 23

Standardet e Cilësisë së Furnizimit dhe Shërbimit të Operimit të Transmetimit

1. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me të gjitha standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit me energji elektrike të aprovuar nga Rregullatori.
2. Kur Rregullatori kërkon, i Licencuari do të shqyrtoj standardet ekzistuese të përgjithshme dhe minimale të përmbushjes, brenda afatit të përcaktuar nga Rregullatori.
3. I Licencuari do të zbatoj standardet e aprovuara dhe do t'i propozoj ZRRE-së për aprovim procedurën e monitorimit të përmbushjes së standardeve të cilësisë dhe furnizimit me energji elektrike. I Licencuari do të veproj në pajtueshmëri me procedurat e aprovuara.
4. I Licencuari do të dorëzoj në Rregullator çdo vit raport mbi ushtrimin e veprimtarisë lidhur me standardet që duhet përmbushur. Ky raport do të përfshijë informata dhe analiza lidhur me përmbushjen e standardeve sipas këtij Neni.
5. I Licencuari do të publikoj Standardet e cilësisë së furnizimit dhe shërbimit, ashtu siç kërkohen nga Rregullatori, lidhur me përmbushjen ose mospërmbushjen e standardeve të përcaktuara sipas këtij Neni.

Neni 24

Qasja në Tokë dhe /ose në Ndërtesa

1. I Licencuari do të mirëmbaj dhe zbatoj Kodin e tij të Punës i cili përcakton parimet dhe procedurat që do të ndiqen në lidhje me ndonjë person që vepron në emër të të Licencuarit dhe që kërkon qasje në tokë dhe/ose ndërtesë e që lidhet me ushtrimin e aktivitetit të licencuar.
2. Kodi i Punës do të përfshij procedurat për të siguruar që personi që kërkon qasje në tokën dhe/ose ndërtesën, në emër të të Licencuarit:
 - 2.1. posedon aftësitë e nevojshme për të kryer detyrat e kërkuara;
 - 2.2. është trajnuar në mënyrë të duhur për Kodin e Punës të të licencuarit lidhur me tokat dhe ndërtesat e palëve të treta;
 - 2.3. mund të identifikohet nga publiku, dhe
 - 2.4. janë persona të autorizuar për të vizituar dhe hyrë në tokat apo ndërtesat.
3. I Licencuari do të rifreskojë/përditësojë kohë pas kohe Kodin e Punës dhe çdo ndryshim i këtij Kodi do t'i nënshtrohet aprovimit nga Rregullatori.

Neni 25

Kufizimi në Përdorimin e Informatës së Caktuar

1. I Licencuari duhet të siguroj konfidencialitetin e të dhënave të ndjeshme komerciale të siguruara dhe të mbajtura nga ai gjatë kryerjes së detyrave, përgjegjësi dhe funksioneve të autorizuara nga ndonjë ligj në fuqi dhe kjo licencë.
2. Zbulimi i të dhënave të ndjeshme komerciale tek ndonjë person tjetër përveç personit me të cilin kanë të bëjnë të dhënat është i ndaluar kur një zbulim i tillë mund të ndaloj, kufizoj apo çrregulloj konkurrencën në tregun e energjisë.
3. I Licencuari lirohet nga ndalesa për zbulimin e të dhënave të ndjeshme komerciale, lidhur me paragrafin 2 të këtij Neni, vetëm kur:
 - 3.1 zbulimi i tillë lejohet në mënyrë të qartë nga ndonjë ligj, rregull, kod apo licencë; ose
 - 3.2 zbulimi i tillë është bërë në pajtueshmëri me ndonjë obligim që del nga ligjet e Komunitetit të Energjisë.
4. Në këtë nen ***“informatë e ndjeshme komerciale”*** nënkupton informatën që, nëse i zbulohet ndonjë personi me të cilin nuk ka të bëjë, i mundëson atij personi përparësi të padrejtë në konkurrencë dhe do të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në, plane operationale në kohë-reale ose afërsisht reale të njësive të gjenerimit, kostove të gjenerimit dhe të dhënave të tjera teknike, financiare ose operationale dhe të dhëna të tjera që arsyeshëm pritet që tu ofrojnë konkurrentëve avantazh të padrejtë në tregun e Kosovës ose ndonjë treg tjetër.
5. I Licencuari duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e duhura për të siguruar që vepron në përputhje me kërkesat e këtij Neni dhe dispozitat e legjislacionit në fuqi, duke përfshirë vendosjen e të gjitha masave, përfshirë politikën, procedurat dhe masat e arsyeshme mbrojtëse elektronike ose të tjera për të siguruar që informatat e ndjeshme komerciale janë identifikuar dhe nuk janë zbuluar, në kundërshtim me këtë Nen.
6. I Licencuari duhet të sigurohet që gjithë menaxhmenti dhe stafi që kanë qasje në të dhëna të tilla janë të trajnuar, për të shmangur rrezikun e ndonjë zbulimi të paramenduar ose të paqëllimshëm të informatës së ndjeshme komerciale.
7. Brenda tre (3) muajsh pas hyrjes në fuqi të kësaj licence të modifikuar, i Licencuari duhet të njoftoj ZRRRE për masat që janë ndërmarrë për të siguruar pajtueshmëri me këtë Nen.

Neni 26

Dhënia e Informatave Operatorëve të tjerë të Sistemit dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes

Në mënyrë që të siguroj funksionim efikas, zhvillim dhe operim të kordinuar të sistemeve të ndërlidhura, i Licencuari do t'i dërgoj çdo informatë të nevojshme Operatorit të Tregut,

Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, shfrytëzuesve të sistemit të transmetimit dhe operatorëve të ndërlidhur të sistemeve fqinje, në mënyrën dhe kohën që arsyeshëm mund të jetë kërkuar nga Operatori i Tregut, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, shfrytëzuesve të sistemit të transmetimit dhe operatorët e sistemeve fqinje.

Neni 27

Pavarësia Ligjore dhe Menaxheriale

1. Për të siguruar pavarësinë e të Licencuarit, në përputhje me Nenin 11.2 të Ligjit për Energjinë Elektrike, duhet të zbatohen kriteret e mëposhtme:
 - 1.1 Personat përgjegjës për menaxhimin e të Licencuarit nuk do të marrin pjesë në strukturën e ndonjë ndërmarrje përgjegjëse, direkt ose tërthorazi, për kontrollin e përditshëm operacional të ndërmarrjeve të përfshira në prodhimin, shpërndarjen dhe furnizimin me energji elektrike në Kosovë, dhe
 - 1.2 I Licencuari do të ndërmerr të gjitha masat e domosdoshme për të siguruar se interesat profesionale të personave përgjegjës për menaxhimin e të Licencuarit janë marr parasysh në një mënyrë që siguron se ata janë në gjendje të veprojnë në mënyrë të pavarur.
2. I Licencuari do të zbatoj Kodin e tij të Sjelljes për Operatorin të Sistemit të Transmetimit ku përcaktohen masat e domosdoshme që sigurojnë përjashtimin e sjelljeve diskriminuese. Gjithashtu ky kod do të përmbajë obligimet specifike të drejtorëve dhe të punësuarve të tjerë lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me konfidencialitetin, konfliktin e interesit etj.
3. I Licencuari herë pas here duhet të rifreskoj/përditësoj Kodin e Sjelljes dhe çdo ndryshim i këtij Kodi duhet t'i dërgohet Rregullatorit për aprovim.
4. I Licencuari do të publikoj Kodin e tij të Sjelljes në faqen e tij zyrtare elektronike.

Neni 28

Rregullat e Tregut dhe Integrimi i Tregut

1. I Licencuari do të veproj në pajtim me Rregullat e Tregut në fuqi.
2. I Licencuari duhet të bashkëpunoj dhe të koordinohet me Operatorin e Tregut dhe operatorët e tjerë të licencuar në organizimin e tregjeve të energjisë elektrike të një dite përpara dhe atyre brenda ditës për tregtim fizik të energjisë elektrike në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
3. I Licencuari duhet të promovoj dhe lehtësoj integrimin e tregut të energjisë elektrike të Kosovës me tregjet e tjera regjionale.

Neni 29 **Shëndeti dhe Siguria**

1. I Licencuari do të ndërmarr të gjithë hapat e nevojshëm për të mbrojtur personat nga lëndimet dhe dëmtimet që mund tu shkaktohen atyre nga ana e të Licencuarit gjatë kryerjes së aktivitetit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit në përputhje me legjislacionin në fuqi.
2. I Licencuari, në përputhje me legjislacionin në fuqi, do të kryej kontroll (auditime) të sigurisë teknike të Sistemit të Transmetimit në baza vjetore, dhe rezultatet e kontrolleve të tilla, do t'i dërgoj në Rregullator, sa herë që kjo kërkohet nga Rregullatori.

Në këtë Nen:

“Siguri teknike” – nënkupton të gjitha masat për të siguruar disponueshmërinë e Sistemit të Transmetimit për operim dhe shfrytëzim në mënyrë të sigurt, pa rrezikuar personelin, pajisjet, ambientin dhe palët që mund të ndikohen prej tij.

Neni 30 **Puna**

I Licencuari, lidhur me marrëdhënien dhe sigurinë në punë do të veproj në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.

Neni 31 **Obligimi i Sigurimit**

1. Licencuari do të bëjë sigurimin e aseteve në pajtim me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
2. I Licencuari do të lidh kontrata për sigurimin e aseteve të sistemit të transmetimit dhe për pajisjet që përdoren për transmetimin e energjisë elektrike. Kontrata e tillë do t'i dërgohet Rregullatorit për rishikim në baza vjetore.

Neni 32 **Ndryshimi në Kontrollin e të Licencuarit dhe Certifikimi i të Licencuarit**

1. I Licencuari do të njoftoj Rregullatorin për ndonjë ndryshim që pritet në kontroll së paku gjashtëdhjetë (60) ditë paraprakisht. Ndryshimi në kontroll nuk do të jetë efektiv deri sa Rregullatori nuk e aprovon atë.
2. I Licencuari do të njoftoj Rregullatorin për ndonjë ndryshim të strukturës organizative të të Licencuarit. Njoftimi i tillë do t'i bëhet Rregullatorit jo më vonë se tre (3) ditë nga data e çdo ndryshimi të tillë.
3. Njoftimi i dorëzuar në Rregullator, lidhur me paragrafin 1 të këtij Neni, duhet të ofroj një vlerësim të detajuar nga i Licencuari deri në masën të cilën i Licencuari konsideron se ndryshimi në kontroll ndikon në statusin e certifikimit.

4. Ku, sipas Rregullatorit, ndryshimi në kontroll mbi të Licencuarin kërkon që procedura e certifikimit të rihapet, i Licencuari duhet të riaplikoj për certifikim, në pajtueshmëri me Rregullën për Certifikim, të miratuar nga Rregullatori.
5. I licencuari duhet të veproj në pajtim me Rregullën për Certifikim në fuqi.

Neni 33

Obligimet e Shërbimit Publik

1. I Licencuari do të kryej çdo obligim të shërbimeve publike që mund t'i vendoset nga Rregullatori, sipas Nenit 51 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
2. Kur në vendimin e Rregullatorit, për imponimin e obligimit të shërbimit publik mbi të Licencuarin, vendoset ndonjë kusht për zbatim, atëherë kushtet e tilla do të konsiderohen si pjesë përbërëse e kësaj licence.

Neni 34

Sigurimi i Informacioneve ndaj Rregullatorit

1. I Licencuari do të dorëzoj në Rregullator informacione dhe raporte në mënyrën dhe në afatet që Rregullatori mund t'i konsiderojë të përshtatshme.
2. I Licencuari do të dërgoj në Rregullator raporte, mbi veprimtarinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit si dhe pajtueshmërinë me kushtet e Licencës sipas Doracakut të Raportimit për Sektorin e Energjisë, të miratuar nga Rregullatori, dhe sipas kërkesave të Rregullatorit.
3. Nëse i Licencuari, në përputhje me Rregullën për Informatat Konfidenciale, kërkon që një informacion i caktuar të konsiderohet si konfidencial atëherë është obligim i tij që të shënoj atë informacion si konfidencial dhe të arsyetoj kërkesën e tij në ZRRE. ZRRE do të shqyrtoj kërkesën e tillë në pajtim me Rregullën për Informatat Konfidenciale.
4. ZRRE ka të drejtë të kërkojë nga i licencuari çdo informatë konfidenciale, të nevojshme për përmbushjen e funksioneve dhe detyrave të saj, në pajtim me Nenin 12 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë.
5. I Licencuari duhet t'i dërgoj Rregullatorit detajet për çdo ndryshim në informata që janë dërguar gjatë aplikimit për këtë licencë.

Në këtë Nen:

"Informacion" – nënkupton materialin në çdo formë dhe pa asnjë kufizim do të përfshijë çdo kontratë, libër, dokument, regjistër, kontabilitet, llogaritje (statusore ose tjetër), vlerësim, kthim ose raport të çdo përshkrimi dhe çdo shpjegim (gojor ose me shkrim) në lidhje me këto informacione që mund të jenë kërkuar nga Rregullatori.

Neni 35

Taksat

I Licencuari duhet t'i paguaj Rregullatorit çdo taksë fillestare apo vjetore, siç përcaktohet në Rregullën për Taksat, të miratuar nga Rregullatori.

Neni 36

Vazhdimi, Modifikimi, Pezullimi, Transferimi dhe Ndërprerja e Licencës

1. Rregullatori mund të vazhdoj, modifikoj, pezulloj, dhe ndërpres këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë.
2. Rregullatori mund të transferoj këtë licencë në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, por duke siguruar që obligimet e licencës mund të kryhen nga një i Licencuar tjetër, nëse konsumatorët nuk do të dëmtohen për shkak të transferimit të tillë.

Neni 37

Masat Administrative dhe Gjobat

1. Në rast shkeljeje të dispozitave të legjislacionit në fuqi, përfshirë Rregullat e nxjerra nga Rregullatori, Nenet e kësaj Licence apo udhëzimet dhënë të Licencuarit nga ana e Rregullatorit, Rregullatori ka kompetenca t'i vendos të licencuarit masa administrative dhe gjoba, në përputhje me Nenin 57 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
2. Masat administrative dhe gjobat mund t'i vendosen ndërmarrjes si subjekt juridik si dhe personave përgjegjës të ndërmarrjes.
3. Shuma e gjobës do të vlerësohet në pajtim me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.

Neni 38

Zgjidhja e Kontesteve

1. Çdo kontest që paraqitet apo është i lidhur me aktivitetet e licencuara do të zgjidhet në përputhje me Nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në sektorin e energjisë, të nxjerrë nga Rregullatori.
2. Vendimet e Rregullatorit lidhur me vazhdimin, modifikimin, pezullimin, ndërprerjen dhe transferin e licencës si dhe vendimet lidhur me gjobat si rezultat i shkeljeve të kushteve të licencës apo shkeljes së ligjeve të aplikueshme, mund të kontestohen nga i Licencuari në gjykatën kompetente sipas ligjeve në fuqi.

Neni 39
Hyrja në fuqi

1. Në pajtim me Nenin 36 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, kjo licencë e ndryshuar (modifikuar), tani me numër regjistrimi ZRRE/Li_15/17 i lëshohet **Operatorit të Sistemit të Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) SH.A**, për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike, dhe hynë në fuqi me datë 13.04.2017.
2. Licenca e lëshuar me datë 04 Tetor 2006 (Nr. i Licencës ERO/Li_15/06), e modifikuar me 18.07.2012 (Nr. i Licencës ZRRE/Li_15/12), tani e modifikuar 13.04.2017 (Nr. i Licencës ZRRE/Li_15/17) do të vazhdoj të jetë e vlefshme për një periudhë tridhjetë (30) vjeçare, deri më 04 Tetor 2036.

E vulosur me vulën e rëndomtë të Zyrës së Rregullatorit për Energji me: _____

Nënshkruar (në emër të Bordit të Rregullatorit) U.D Krenar Bujupi: _____

Nënshkruar më: 13.04.17.

Fundi i dokumentit